



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 01.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetesise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.02.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Shqiponja SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Shërbimet e Bifesë në MSh**” me nr. prokurimi 206-23-14122-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si e bazuar kërkesa per rishqyrtim e OE **Shqiponja SH.P.K.**, e datës 28.02.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Shërbimet e Bifesë në MSh**” me nr. prokurimi 206-23-14122-2-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 23.02.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. Kthehet ne Rivleresim AP “**Shërbimet e Bifesë në MSh**” me nr. prokurimi 206-23-14122-2-2-1;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik Shqiponja SH.P.K., me datë 28.02.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e Bifesë në MSh” me nr. prokurimi 206-23-14122-2-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 01.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

- Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 23.02.2024 mbi rezultatin e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës; **Sherbimet e byfësë ne Ministrin e Shëndetësisë , ku është propozuar për shpërbllim të kontratës Operatori ekonomik; Demos shpk,l me vlerën totale të çmimit të peshuar prej 70,850.00 euro.**

Pretendojmë e se Autoriteti Kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

1. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, *(në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së dhe atë) konkretisht:*

- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi

II/ Dispozitat e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik të datës 01.11.2022. dhe Udhëzuesit nr.001 /2023 për Prokurimin Publik

- Pika 10 e Udhëzuesit për Prokurim Publik

Pretendimi ankimor

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në vazhdim të kësaj Kërkesë për Rishqyrtim të vendimit do të përpiqemi që të argumentojmë shkeljet e pretenduara të:

1. Të dispozitave të LPP-se në RK.

x Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

- 1.1. *së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në*

njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji. Marre parasysh faktin që AK është i obliguar që tenderin ta vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje të OE të përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit si dhe bazuar në Vendimin e AK-se për shpërblim të kontratës, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik komforë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

x Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-se në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i kompanisë Demos shpk, është i përgjegjshëm dhe është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.

Të ju përkujtojmë se kërkesat për kualifikim dhe përzgjedhje të OE janë të përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 59. paragrafi 4 të këtij ligji:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Në paragrafin 27 të Informacioneve për tenderuesit të dosjes së tenderit në mënyrë detale është e parashikuar vlerësimi dhe ekzaminimi, krahasimi i tenderit.
Citoj dispozitat e këtij paragrafi;

21.1 Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të procedurës së përcaktuar në Rregulloren për Prokurimin Publik.

21.2 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit;*
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;*
- c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.*

Të qenët "në pajtueshmëri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e

kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit duke mos u larguar substancialet nga to dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

Bazuar ne kërkesa te AK-se te përcaktuara ne njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit shohim se Autoriteti Kontraktues ne Njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit ne paragrafin 7.1 & 7.2 te Kërkesës për plotësimin e përshtatshmërisë profesionale ka kërkuar;

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit	Certifikata e regjistrimit të biznesit- ARBK-në me informatat për biznesin (kopje).
		Kërkesa 2.Certifikatë e numrit fiskal .	Evidenca 2.Te dëshmohet me Certifikatë te Numrit Fiskal- Kopje
		Kërkesa 3.Certifikatë e TVSh-së.	Evidenca 3.Te dëshmohet me Certifikatë te TVSh-së Kopje

Bazuar ne dëshminë dokumentare te OE te propozuar për kontrate shohim se OE ka ofruar Certifikatën e biznesit e cila përmban aktivitetin kryesor te biznesit i cili ka te beje me; Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimin teknik , ndërkaq Veprimtari tjera ka te regjistruara disa veprimtari , por nuk ka te regjistruar veprimtarinë kryesore të kërkuar ne FDT Restorante dhe aktivitet shërbyese, lëvizëse të ushqimit.

Pretendojmë se ky OE nuk është i kualifikuar ne pikëpamje profesionale .

Bazuar ne faktet e lartë shënuara pretendojmë se AK ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se.

Bazuar ne kërkesën e AK-se te përcaktuara ne njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit shohim se Autoriteti Kontraktues ne Njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit ne paragrafin 9.1 & 9.2 te Kërkesës se për plotësimin e kapacitetit teknik /profesional ka kërkuar;

Citoj kërkesën e AK-se;

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		<p>1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte (shërbime te hotelierise-gastronomise) gjate tri viteve te fundit duke fillura nga data e publikimit te Njoftimit për Kontrate</p> <p>2. Operatori ekonomik duhet te ketë staf për kryerjen e shërbimeve te gastronomisë si ne vijim:</p> <p>a. Minimum 1 (një) Banakier me minimum 2 vjet përvoje pune</p> <p>b. Minimum 3 Kamerierë me minimumi me minimum 1 vit përvoje pune (2 kamerier për shërbim të stafit dhe 1 kamerier për shërbim brenda bifës.</p>	<p>1. Listën e kontratave ne të cilën specifikohen të gjitha shërbimet e kryera te gastronomisë të realizuara në tri vitet e fundit. Listës duhet ti bashkëngjiten .</p> <p>a. Kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohet referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë; Ne reference duhet te jete shënuar vlera e realizimit te shërbimeve. Nëse ne reference nuk është shënuar vlera e realizimit sipas kontratës , atëherë referencës ti bashkëngjiten edhe dëshmitë tjera që vërtetojnë vlerën e realizuar sipas kontratave.</p> <p>b. Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë. Çdo dokument duhet qe ta ketë te shënuar vlerën e realizimit te shërbimeve.</p> <p>2. Lista e stafit e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Listës duhet bashkangjitur CV, kontratat e punës ose para kontrata për secilin staf.</p>

Bazuar ne kërkesën e AK-se, te përcaktuar ne FDT, te Kërkesave mbi mundësitë teknike/profesionale Autoriteti kontraktues ka kërkuar;

2. . . Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte (shërbime te hotelerisë -gastronomisë) gjate tri viteve te fundit duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për Kontrate

Ndërkaq për dëshmi dokumentare ka kërkuar. Operatori Ekonomik;

1. Listën e kontratave ne të cilën specifikohen të gjitha shërbimet e kryera te gastronomisë të realizuara në tri vitet e fundit. Listës duhet ti bashkëngjiten

AK ka vlerësuar ekzaminuar dhe krahasuar tenderin ne kundërshtim te plote me kërkesën e vet te përcaktuar ne FDT te tenderit ne fjale ne momentin kur ka pranuar Listën e kontratave si dhe dëshmitë /referencat si dëshmi konform kërkesës se AK-se.

Bazuar ne Listën e kontratave te cilën e ka prezantuar Operatori ekonomik i propozuar për shpërblim me kontratë shohim se Lista e kontratave përmban te dhëna se OE ka përfunduar një kuotim me vlere minimale ne vlerë prej 966.42 dhe atë Furnizimi me ushqim dhe pije për festen e fund vitit. Pretendojmë se Lista e kontratave e cila është dorëzuar se bashku me dosjen e tenderit nuk ka plotësuar kërkesën e AK-se.

OE I propozuar për kontrate për kërkesën ne paragrafin 9.1&9.2 pika 2 te AK-se, për dëshmi dokumentare ka bashkëngjitur ;Kopje te referencës nga pranuesi i shërbimeve.

Pretendojmë se kjo reference nuk janë valide pre arsye se nuk është për shërbime hoteliere - gastronomisë por është kontrate furnizimi.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim te plote me Udhëzuesin Nr.001/2023 për Prokurimin Publik ne rastin kur nuk ka kërkuar Sqarim te tenderit konforme nenit 72 te LPP-se dhe nenit 38 te Rregullores për Prokurimin Publik lidhur me Listën e kontratave. Sepse Udhëzuesi ne piken 10 përcakton me sa vijon;

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje nie nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Problemi

Si të veprohet? Neni i

LPP-
së

Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkohe informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Autoriteti kontraktues, është dashur menjëherë te veproj ne pajtim me piken 10 te Udhëzuesit nr.01/2023 për Prokurimin Publik dhe te refuzoj tenderin sepse Lista e kontratave nuk ka përmbushur kërkesat minimale për vlerën e përcaktuar

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga Komisioni për rishqyrtimin e Vendimeve te AK-se që pas administrimit te provave dhe fakteve :

- Të aprovoj Kërkesën për rishqyrtim te Operatorit ekonomik Shqiponja BFB ” si të bazuar,
- Të anuloj, Njoftimin mbi Vendimin e AK-se te datës 23.02.2024, mbi rezultatit e tenderit ku është propozuar për shpërblim te kontratës OE: Demos shpk me seli ne Fushe Kosove, ne vlere prej 70,860.00 euro.
- Të kthej tenderin në Rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes te cilat janë te përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pajtohemi me pretendimet e juaja ankimore, komisioni vleresues ka konsideruar se referenca e OE te rekomanduar me titull: Furnizim me ushqim dhe pije për festa te fundvitit, ne vlere 966.42 € e ploteson kriterin e tenderit, duke marre parasysh edhe çmimin me te lirë te ofertes DEMOS SH.P.K. prej 70,850.00€, krahasuar me oferten tuaj prej **90,000.00 €**.

Por ne kete faze te shqyrtimit te pretendimeve tuaja, po e shohim se keni te drejte dhe se lenda duhet te kthehet ne Ri-vleresim nga ana e AK-MSh.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Shqiponja SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit